

Mbështetur në nenin 34 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë, Themeluesit e Shoqërisë Aksionare më dt. 11/08/2020 nxjerrin:

STATUTIN

E

NDËRMARRJE PUBLIKE LOKALE STACIONI AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A.

(Emërtimi i Shoqërisë)

Rahovec, Rahovec, Xhelal Hajda Toni, p.n

(Selia)

Neni 1

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Me këtë Statut rregullohen çështjet e përgjithshme me rëndësi për statusin, organizimin dhe afarizmin e Shoqërisë aksionare **NDËRMARRJE PUBLIKE LOKALE STACIONI AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A.** në **Rahovec, Rahovec, Xhelal Hajda Toni, p.n:**


- Emërtimi dhe selia
- Themeluesit e Shoqërisë
- Aksionet
- Veprimtaria
- Kapitali themeltar dhe pasuria
- Ndarja e fitimit
- Organet e Shoqërisë
- Detyrimi për mos konkurrencë
- Rezervat dhe pasuria
- Të punësuarit
- Shpërbërja e Shoqërisë
- Dispozitat përfundimtare

Neni 2

Shoqëria është themeluar me Marrëveshjen mbi themelimin e Shoqërisë Aksionare **NDËRMARRJE PUBLIKE LOKALE STACIONI AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A.**, të cilën e kane miratuar themeluesit më dt. 11/08/2020.

Neni 3

Shoqëria është person juridik e cila në mënyre të pavarur paraqitet dhe ka të gjitha autorizimet në marrëdhëniet juridike me personat e tretë.



Neni 4

Në harmoni me atë, Shoqëria ka të drejtë të lidhi Kontrata dhe kryej pune tjera juridike dhe ndërmerr veprime në kuadër të aftësive të veta juridike dhe afariste.

Neni 5

Shoqëria në qarkullimin juridik paraqitet në emër dhe llogari të vet, ndërsa për veprimet e veta përgjigjet me tërë pasurinë e vet.

Neni 6**EMËRTIMI DHE SELIA**

Shoqëria vepron nën emërtimin: **NDËRMARRJE PUBLIKE LOKALE STACIONI AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A.** në Rahovec, Rahovec, Xhelal Hajda Toni, p.n.

Neni 7

Emërtimi i shkurtë është: **NDËRMARRJE PUBLIKE LOKALE STACIONI AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A.**, Rahovec, Rahovec, Xhelal Hajda Toni, p.n.

Neni 8

Selia e Shoqërisë është në **Rahovec, Rahovec, Xhelal Hajda Toni, p.n.**

Personi i Autorizuar i kësaj shoqërie tregtare është **Behar Gashi,(Drejtör)** , i cili është person i ligjshëm për pranimin e shërbimeve, njoftimeve, kërkesave si dhe akteve tjera që dërgohen nga autoritetet publike.

Neni 9**THEMELUESIT E SHOQËRISË**

Themeluesit e Shoqërisë janë:

1. Komuna e Rahovecit me 100% gjegjësisht 25000.0000 Euro (me shkronja)

Neni 10**AKSIONET**

Aksioni është tërësi e të gjitha të drejtave dhe obligimeve që i takojnë një anëtar të Shoqërisë bazuar në kapitalin fillestar.

Neni 11**Lartësia e aksioneve**

Aksionet përcaktohen me përqindje si ne vijim :

1. Komuna e Rahovecit me 100% gjegjësisht 25000.0000 Euro (me shkronja)

Neni 12

Libri (regjistri) i aksioneve

Librin e aksioneve e mban Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve në mënyrë siq është përcaktuar me ligj.

Në raport me Shoqërinë, anëtar i Shoqërisë është vetëm ai i cili është i regjistruar në Librin e aksioneve.

Kryesuesi i Bordit është i obliguar që anëtarit të Shoqërisë në kërkesë të tij të i lëshoi Vërtetim mbi anëtarësinë në Shoqëri me të dhënat të cilat janë lëndë e regjistrimit në Librin e aksioneve. Para mbajtjes së Kuvendit të Shoqërisë, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve është i obliguar që anëtarit të ia lëshoi vërtetimin me të dhënat për numrin e votave të cilat i ka para nxjerrjes së Vendimeve në Kuvend.

Neni 13

Disponimi me aksione

Aksionet mund të barten dhe trashëgoohen. Është e lejuar bartja e një pjese të aksionit, me kusht që aksionet së pari të iu ofrohen anëtarëve të Shoqërisë sipas vlerës së atëhershme të regjistruar në kontabilitet.

Nëse anëtari i Shoqërisë krijon aksione te reja, secili pjesë e aksioneve të atij anëtari ruan pavarësinë.

Për bartjen e aksionit apo një pjese të aksionit është e nevojshme të lidhet Kontratë.

Bartja e aksioneve apo pjesëve të aksioneve në mes anëtarëve të Shoqërisë është e lirë. Anëtari mundet që pjesën e aksionit të vetë ta bartë në Shoqëri nëse janë të plotësuara kushtet për fitimin e aksioneve vetanake.

Për bartjen e aksioneve apo një pjesë të aksioneve personave të tretë të cilët nuk janë anëtarë të Shoqërisë, nevojitet pëlqimi i Shoqërisë. Pëlqimin në emër të Shoqërisë e jep Kuvendi i cili mundet të ndaloj dhënien e pëlqimit për ndarje dhe bartje të aksioneve apo pjesës së aksioneve.

Bartja e aksioneve e cila është kryer në kundërshtim me dispozitat e këtij Statuti nuk prodhon efekt juridik dhe si i tillë është nul.

Neni 14

VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

Shoqëria kryen veprimtarinë si në vijim:

5221 - Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor

5229 - Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit

Neni 15

Shoqëria ka të drejtë që në kuadër të veprimtarisë së regjistruar të kryej edhe punët e qarkullimit të jashtëm tregtar.

Neni 16**KAPITALI THEMELOR DHE PASURIA E SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është monetar, në shume prej 25000.00 Euro.

1. Komuna e Rahovecit me 100% gjegjësisht 25000.0000 Euro (me shkronja)

Të gjitha investimet e ardhshme nga themeluesit do të jenë në proporcion me përqindjen e kapitalit që e kanë deponuar në Shoqëri.

Themeluesi ka të drejtë në kthimin e kapitalit të deponuar në Shoqëri në rast të ndërprerjes së punës së Shoqërisë si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligj dhe Aktet e përgjithshme të Shoqërisë.

Neni 17**Rritja e kapitalit themelor**

Për rritjen e kapitalit themelor është i nevojshem Vendimi i Kuvendit mbi ndryshimin e këtij Statuti.

Kapitali themelor mund të rritet me pagesën e aksioneve të reja apo rritjen e ekzistueseve por edhe me deponimin e sendeve dhe të drejtave ose rezervës dhe fitimit të Shoqërisë në kapitalin themelor.

Neni 18**Zvogëlimi i kapitalit themelor**

Zvogëlimi i kapitalit themelor mund të zvogëlohet vetëm në bazë të Vendimit të Kuvendit të Shoqërisë mbi ndryshimin e këtij Statuti .

Neni 19**NDARJA E FITIMIT DHE MËNYRA BARTJES SË RREZIQEVE DHE MBULIMI I HUMBJEVE**

Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në fund të vitit afarist, me të cilin nënkuptohet viti kalendarik, e në pajtim me dispozitat në fuqi dhe ato të përcaktuara me Aktet e përgjithshme të Shoqërisë.

Neni 20

Fitimin e Shoqërisë e përcakton Kuvendi ashtu që nga rezultatet afariste të Shoqërisë në një vit afarist kryen largimin e të gjitha shpenzimeve afariste duke përfshi edhe të gjitha të ardhurat e punëmarrësve si dhe pagesat tjera sipas bazës së kontributeve, tatimeve dhe obligimeve tjera fiskale.

Ndarja e fitimit realizohet pas aprovimit të llogarisë përfundimtare dhe raportit mbi afarizëm nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 21

Mbi përdorimin e fitimit të realizuar dhe mbulimin e humbjeve vendos Kuvendi në pajtim me ligjin dhe këtë Statut.

Neni 22

Fitimi i realizuar u takon themeluesve të cilët me të lirshëm disponojnë dhe e ndajnë në përpjesëtim me aksionet e tyre.

Neni 23

Themeluesi ka të drejtë që në tërësi ta tërheqin fitimin e realizuar, si dhe në tërësi apo pjesërisht ti ri investoj gjegjësisht të bëjë de-kapitalizimin në Shoqëri pas përfundimit të vitit afarist.

Neni 24

Nëse Shoqëria përfundon vitin afarist me humbje, ajo kompensohet nga fitimi i Shoqërisë nëse një fitim i tillë ekziston.

Nëse Shoqëria nuk ka fitim të realizuar, humbjet kompensohen nga kapitali themeltar, që përcaktohet me Vendim me rastin e aprovimit të llogarisë përfundimtare në të cilën rast ajo humbje është paraqitur.

Nëse Shoqëria sipas llogarisë vjetore paraqet humbje, ajo do të mbulohet nga burimet e përcaktuara me dispozitat në fuqi.

Neni 25

Shpenzimet e punës dhe afarizmit të Shoqërisë mbulohen nga mjetet në llogarinë rrjedhëse.

Neni 26

Themeluesit bartin rrezikun për afarizëm të Shoqërisë me të gjithë pasurinë që kanë.

Neni 27

ORGANET E SHOQËRISË

Shoqëria ka këto Organe: Kuvendin si organ vetëqeverisës dhe Bordin e Drejtoreve si organ ekzekutiv afarist.

Neni 28

Kuvendi

Kuvendin e përbejnë të gjithë anëtarët e Shoqërisë.

Neni 29

Kompetencat e Kuvendit

Kuvendi vendos për këto çështje :

- ndryshimin dhe plotësimin e Statutit ose akteve normative të Shoqërisë;
- zgjedhjen ose shkarkimin e Drejtorëve ;
- autorizimin për bashkim ose transaksionet e mëdha sipas dispozitave ligjore (nenit 211 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare);
- shpërbërjen e Shoqërisë sipas nenit 229 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- emrimin e auditorëve të pavarur të Shoqërisë;
- miratimin e deklaratave financiare vjetore të Shoqërisë dhe të cilat përgaditen në pajtim me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe të publikohen në baza vjetore në mediat masive dhe
- Çështjet tjera që kanë rëndësi të veçantë.

Neni 30

Mbledhjet e Kuvendit

Kuvendi mban këto lloje të mbledhjeve:

1. mbledhje vjetore të aksionarëve
2. mbledhje të jashtëzakonshme të aksionarëve dhe
3. mbledhje sipas urdhrit të gjykatës.

Neni 31

Mbledhja vjetore e aksionarëve

Shoqëria duhet të mbajë një Kuvend (mbledhje vjetore) të aksionarëve e cila mbahet brenda 30 ditëve pasi Bordi të marr raportin e auditimit financiar për vitin financiar por jo më shumë se 90 ditë pas përfundimit të vitit financiar të Shoqërisë.

Bordi duhet të siguroi që Aksionarëve të iu dorëzohet Deklarata e audituar financiare e Shoqërisë së paku 30 ditë para mbledhjes vjetore.

Kuvendi i aksionarëve mbahet në Rahovec, Rahovec, Xhelal Hajda Toni, p.n.

Mbledhja thirret nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 32

Njoftimi për Kuvend (mbledhjen vjetore) dhe Procedimet

Njoftimi për Kuvend të aksionarëve duhet t'i dërgohet secilit aksionar së paku tridhjetë (30) ditë më herët në adresat e listuara për secilin aksionar në regjistrin e aksionarëve si dhe secilit anëtar të Bordit të Drejtorëve. Për më tepër, njoftimi duhet të bëhet përmes publikimit ashtu siç kërkohet me ligj.

Njoftimi duhet të përfshijë kohën dhe vendin e mbajtjes së Kuvendit dhe agjendën. Në njoftim duhet të ceket se nëse ndonjë palë nuk do të jetë prezent në Kuvend atëherë kjo e fundit mund të shtyhet për më vonë për ndonjë datë më

të përshtatshme, duke përcaktuar kohën dhe vendin: një datë e fillë nuk mund të jetë më herët se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas datës së caktuar për mbledhjen e as tridhjetë (30) ditë pas saj.

Dështimi për ti njoftuar për Kuvend secilin aksionar mund të eliminohet nëse ai person merr pjesë në Kuvend personalisht apo i autorizuari i tij. Dështimi për ta njoftuar për Kuvend secilin anëtar të Bordit të Drejtorëve mund të eliminohet nëse shumica e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve merr pjesë në Kuvend personalisht.

Secila kërkesë për njoftim do të konsiderohet e braktisur nëse Kuvendi vepron sipas vendimit të shkruar dhe nëse është e nënshkruar nga të gjithë Anëtarët e pranishëm.

Kryesuesi i Kuvendit duhet të jetë në gjendje të udhëheqë Kuvendin, të përcaktoj dhe të deklaroj rezultatet e votimit;

Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë për pikat e agjendës, gjithashtu të lexojnë, të pranojnë apo të dërgojnë dokumentet e ndërlidhura (nëse ka ndonjë).

Neni 33

Kuorumi për Kuvend

Kuvendi mund të mbahet vetëm nëse ka kuorum. Kuorumi përcaktohet kur janë prezent aksionarët apo të autorizuarit e tyre. Kuorumi është i arritshëm nëse aksionarët (apo personat e tyre të autorizuar) duke përfaqësuar së paku pesëdhjetë (50%) për qind të aksioneve votuese të Shoqërisë që janë të evidentuar si prezent në Kuvend .

Nëse nuk ka kuorum brenda një periudhe të arsyeshme kohore pas kohës së përcaktuar për fillim, mbledhja vjetore duhet të ndërpritet apo të shtyhet për një datë të përshtatshme që është e përcaktuar në njoftim .Që një mbledhje e tillë vjetore të shtyhet, kuorumi duhet të ketë njëzetë e pesë për qind (25%) e pjesës votuese të Shoqërisë. Nëse në Kuvend të shtyrë nuk ka kuorum brenda një periudhe të arsyeshme kohore , mbledhja do të anulohet.

Neni 34

Kryesuesi i Kuvendit

Kryesuesi(GEZIM ZEKA) i Bordit të Drejtorëve apo personi i zgjedhur nga shumica e pjesës së pranishme në Kuvend duhet të jetë Kryesues i Kuvendit. Kryesuesi i Kuvendit duhet që duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këtë statut, të konstatoj prezencën e kuorumit, të drejton debatin, të mbaj procesverbalin ,të konstatoj dhe deklaron rezultatet e votimit.

Neni 35

Mbledhjet e jashtëzakonshme të aksionarëve

Shoqëria e mban mbledhjen e jashtëzakonshme të aksionarëve :

1. Me kërkesën e Bordit të Drejtorëve ose me kërkesën e një personi të autorizuar për qëllimin e caktuar ose
2. Nëse pronarët e më së paku 10% të të gjitha votave që kanë të drejtë të hidhen për një çështje në mbledhjen e propozuar, nënshkruajnë e vendosin datën dhe i dorëzojnë Shoqërisë një kërkesë me shkrim për mbajtjen e mbledhjes ku në kërkesë duhet theksuar: emrin, adresën ,numrin e aksioneve të cilat i mbajnë, qëllimin dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Brenda 15 ditësh pas pranimit të kërkesës nga Shoqëria, Bordi i Drejtorëve duhet ta miratoi Vendimin për caktimin apo refuzimin e mbledhjes. Brenda 5 ditësh pas miratimit të Vendimit Bordi i Drejtorëve u dërgon Njoftim për mbajtjen

e mbledhjes personave që kanë paraqitur kërkesën në adresën e shënuar në kërkesë së bashku me një kopje të Vendimit. Vendimi për refuzimin e mbledhjes mund të miratohet vetëm nëse procedurat e përcaktuara në pikën b, të këtij neni nuk janë përmbushur, ose nëse aksionarët që kanë paraqitur kërkesën nuk e posedojnë numrin e mjaftueshëm të votave që kërkojnë sipas kësaj pike, ose nëse asnjëra nga çështjet e propozuara në kërkesë për mbledhje nuk është në kompetencën e mbledhjes së aksionarëve.

Mbledhja e jashtëzakonshme mbahet në vendin e përcaktuar në statutin e shoqërisë ose (nëse nuk është caktuar aty) në një vend të cilin e cakton bordi i drejtorëve në pajtim me statutin e shoqërisë. Nëse vendi i mbajtjes së mbledhjes nuk përcaktohet me statut dhe nuk përcaktohet nga bordi i drejtorëve, atëherë mbledhja mbahet në zyrën e regjistruar të shoqërisë (Selinë e shoqërisë).

Vetëm çështjet që janë theksuar në kuadër të qëllimit ose qëllimeve të shënuara në njoftimin për mbledhje mund të diskutohen në mbledhjen e jashtëzakonshme.

Neni 36

Mbledhja e Aksionarëve sipas Urdhrit të Gjykatës

Nëse mbledhja vjetore e aksionarëve nuk mbahet brenda 6 muajve të parë pas përfundimit të vitit financiar të shoqërisë, ose katërmëdhjetë (14) muaj pas mbledhjes së fundit vjetore të aksionarëve (ose dymbëdhjetë (12) muaj pas regjistrimit fillestar të shoqërisë, nëse nuk është mbajtur ndonjë mbledhje e mëhershme), gjykata kompetente mund të nxjerr vendim për mbajtjen e mbledhjes pas kërkesës së cilit do drejtor ose cilitdo aksionar i cili ka të drejtë pjesëmarrje dhe vote në mbledhjen në fjalë.

Nëse mbledhja e jashtëzakonshme nuk mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas dorëzimit të kërkesës sipas dispozitave të këtij Statuti, ose datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes, gjykata mund të nxjerrë vendim për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme pas kërkesës së cilitdo aksionar që ka nënshkruar kërkesën.

Gjykata mund të nxjerrë vendime të tjera përkatëse të nevojshme për arritjen e qëllimit të mbledhjes, duke përfshirë edhe vendimin për mbajtjen dhe emërimin e personave që do të kryesojnë mbledhjen nëse bordi refuzon të bëjë këtë, ose vendime mbi vendin dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes, caktimin e datës për përcaktimin e aksionarëve që kanë të drejtë vote, ose të përcaktojë formularin dhe përmbajtjen e njoftimit të mbledhjes.

Neni 37

Votat e Aksionarëve

Secili aksionar emri i të cilit paraqitet në regjistrin e aksionarëve tridhjetë (30) ditë më herët nga data në të cilën është thirrur mbledhja vjetore duhet të ketë një votë për secilin aksion për të cilin ai është mbajtës i regjistruar në regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë.

Secili aksionar i autorizuar do të emërohet me shkrim nga aksionari i caktuar dhe duhet të pranohet nga Zyrtari para fillimit të mbledhjes vjetore.

Vota e dhënë nga i autorizuari duhet të jetë e vlefshme, pa marrë parasysh shkarkimin e mëhershëm të autoritetit të personit votues, përveç nëse njoftimi për shkarkim, është pranuar nga Zyrtari para fillimit të mbajtjes së Mbledhjes vjetore ku edhe është dhënë vota.

Një vendim i vënë në votim në mbledhjen vjetore duhet të vendoset nga numërimi publik. Numërimi duhet të fillojë menjëherë kur udhëheqësi i mbledhjes vjetore udhëzon, në atë mënyrë që mundëson votimet që i përkasin secilit aksion për apo kundër vendimit që të numërohet në mënyrë të saktë. Në rast se ka votim të barabartë Kryesuesi i Kuvendit (nëse ai apo ajo është aksionar) mund të ketë votë vendimtare.

Kuvendi mund të miratoj vetëm vendimet në lidhje me çështjet të cilat janë përmbledhur në agjendë për ndonjë mbledhje të veçantë, përveç nëse aksionarët të cilët përfaqësojnë të gjitha aksionet e Shoqërisë e të cilët kanë të drejtë të votojnë janë prezent dhe pajtohen ndryshe.

Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë aksionarët e Shoqërisë do të ketë të njëjtën fuqi sikurse edhe vendimi që ka kaluar në Mbledhjen vjetore që është thirrur dhe mbajtur. Çfarëdo vendimi i tillë mund të përbëhet prej disa dokumenteve duke pasur formë dhe përmbajtje identike, secili i nënshkruar nga një ose më tepër aksionar.

Neni 38

Bordi i Drejtorëve

Biznesi dhe detyrat e Shoqërisë do të drejtohen nga Bordi i Drejtorëve, siç është përcaktuar në këtë statut dhe ligj.

Bordi i Drejtorëve, formohet në bazë të Ligjit Nr. 06/L-016, "Për Shoqëritë Tregtare", gjegjësisht nenit 159 në këtë përbërje:

1. **Gëzim Zeka, Kryetar i bordit**
2. **Valzon Morina, Drejtor i biznesit**
3. **Erlira Mullabazi, Drejtor i biznesit**
4. **Arta Hoti, Drejtor i biznesit**
5. **Behar Gashi, Drejtor ekzekutiv**

Neni 39

Kompetencat e Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve ka këto kompetenca:

- marrja e Vendimeve mbi të gjitha çështjet përveç vendimeve që iu janë rezervuar aksionarëve me ligj apo këtë Statut
- miratimi i planeve afariste strategjike të Shoqërisë
- konvokimin e mbledhjeve vjetore dhe të jashtëzakonshme të aksionarëve
- përgaditjen e agjendës fillestare të mbledhjes së aksionarëve
- përcaktimi i datës për listën e aksionarëve që kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjen e aksionarëve
- emetimin e aksioneve brenda kufizimeve të parapara në këtë Statut
- mundësinë për blerjen e aksioneve apo letrave me vlerë
- punësimi i zyrtarëve
- Vendorsjen e shpërblimit dhe kushtet tjera të marrëveshjes me auditorin e shoqërisë
- përcaktimin e shumave dhe caktimin e datave të pagesës dhe procedurat për pagesën e dividendave
- miratimin e raportit vjetor të shoqërisë dhe vlerësimin vjetor të fitimit dhe humbjeve të cilat pastaj dorëzohen tek aksionarët për miratim
- si dhe vendorsjen për të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me kompetencën ekskluzive të Bordit të Drejtorëve të përcaktuar me këtë Statut

Neni 40

Mbledhjet e Bordit të drejtorëve

Bordi i Drejtorëve mban një mbledhje të rregulltë e cila njihet si mbledhje vjetore menjëherë pas çdo mbledhje vjetore të aksionarëve. Mbledhjet tjera të rregullta mbahen në kohën dhe vendin të cilin e cakton Bordi në mbledhjen vjetore ose në një mbledhje të Bordit për të cilën janë njoftuar të gjithë Drejtorët.

Njoftimi për mbledhje duhet të ketë agjendën dhe duhet të dorëzohet me dorë së paku tri ditë para mbledhjes me Faks apo E-mail, apo me çfarëdo mënyre tjetër të cilat sigurojnë pranimin me kohë. Në raste të emergjencës, njoftimi për mbledhjen duhet të përcjellët me letër dhe të dërgohet me dorë me Faks apo e-mail, së paku një ditë para mbledhjes.

Në mbledhje, udhëheqësi i Bordit të Drejtorëve, duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këtë Statut, duhet të përcaktoj praninë e kuorumit, të drejtoj debatin, si dhe të mbaj procesverbalin dhe të përcaktoj dhe deklaroj rezultatet e votimit.

Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve kanë validitet nëse prezantojnë shumica e Drejtorëve dhe duhet të veprohet me votën pohuese të shumicës së Drejtorëve pjesëmarrës në mbledhje. Drejtorët të cilët mund të abstenojnë nga votimi dhe Drejtorët të cilët kanë shpalosur konflikt interesash nuk do të përfshihen në numërim në lidhje me shumicën. Në rast barazimi me vota, udhëheqësi i Bordit të Drejtorëve duhet të ketë votën vendimtare.

Nëse, për shkak të boshllëkut, numri i Drejtorëve është më i vogël se numri i vendosur si kuorum, Drejtorët e mbetur (apo Drejtori) mund të veprojnë vetëm për qëllim të thirrjes së Kuvendit për plotësimin e vendeve të lira.

Neni 41

DETYRIMI PËR MOS KONKURENCË

Kryesuesi i Bordit, Drejtorët tjerë si dhe anëtarët e Shoqërisë nuk mund direkt apo indirekt, të rregullt apo përkohesisht, për llogari të vet apo tjetërkujt të kryejnë punë në Shoqëritë tjera tregtare apo tjera të cilat punë Shoqëria i ka të parapara në veprimtarinë e vet. Poashtu ata nuk guxojnë të kenë aksione tjera në Shoqëritë tjera dhe as të jenë anëtarë të Shoqërive të tilla, nëqoftëse atë veprimtari paraprakisht nuk ia lejon Kuvendi.

Neni 42

Nëse anëtari i Shoqërisë vepron në kundërshtim me nenin paraprak, Shoqëria mundet të kërkojë kompensimin e dëmit të shkaktuar.

Neni 43

REZERVAT DHE PASURIA E SHOQËRISË

Shoqëria është e obliguar që të krijoj rezervat obligative. Mbi formimin e rezervave obligative kujdeset Bordi i Drejtorëve.

Në rezervat obligative futen 5% e fitimit deri sa rezervat nuk arrijnë lartësinë 10% të kapitalit themeltar. Pas arritjes së asaj lartësie, rezervat obligative duhet të qëndrojnë në atë nivel.

Vendimin për rezerva tjera eventuale të Shoqërisë të cilat do të formoheshin me ndarjen nga fitimi e nxjerr Kuvendi, nëse vlerëson që rezervat e tilla janë të nevojshme.

Neni 44

Pasurinë e përbëjnë e drejta e pronësisë në sendet e luajtshme dhe paluajtshme, mjetet financiare dhe letrat me vlerë si dhe të drejtat e tjera pronësore.

Neni 45

TË PUNËSUARIT

Vendimet mbi pranimin dhe ndërprerjen e angazhimit të punëtorëve si dhe personave tjerë për nevojat e Shoqërisë i bjen Bordi i Drejtorëve.

Në qeverisjen e Shoqërisë, pjesëmarrjen në fitim dhe realizimin e të drejtave tjera nga marrëdhënia e punës të punësuarit gëzojnë të drejtat e përcaktuara me ligj dhe Aktet normative të Shoqërisë.

Neni 46

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Shoqëria është themeluar për kohë të pacaktuar dhe mund të shpërbëhet vetëm në rastet dhe mënyrën e përcaktuar me ligj dhe këtë Statut.

Neni 47

Kuvendi vendos mbi shpërbërjen. Vendimi nxirret në formë të dokumentit të shkruar publik. Në atë rast zhvillohet procedura e përcaktuar e likuidimit.

Neni 48

DISPOZITAT PERFUNDIMTARE

Kohëzgjatja e kësaj Shoqërie nuk është e kufizuar në kohë. Ajo është themeluar për kohë të pacaktuar.

Neni 49

Shoqërisë mund ti bashkëngjiten dhe aksionarët tjerë duke depozituar mjete të caktuara dhe duke miratuar Aneks Marrëveshjen për themelim dhe Aneks Statutin e Shoqërisë si dhe kushtet tjera të cilat mund të përcaktohen me Aneks Marrëveshje gjegjësisht Aneks Statut.

Neni 50

Aktet e përgjithshme të Shoqërisë duhet të jenë në harmoni me këtë Statut.

Neni 51

Shoqëria mundet ta ndërroi emërtimin, selinë dhe veprimtarinë me Vendim të Shoqërisë në formë të shkruar.

Neni 52

Ky Statut hyn në fuqi 8 ditë pas aprovimit të tij nga Kuvendi.

Neni 53

Marrëveshja për themelim e Shoqërisë hyn në fuqi ditën e regjistrimit të Shoqërisë në ARBK.

Neni 54

Kryesuesi i Bordit të drejtorëve do të kryej regjistrimin e anëtarëve të Shoqërisë në Librin e aksioneve në afat prej 8 ditësh nga dita e regjistrimit të Shoqërisë në ARBK.

Themeluesit:

1. Komuna e Rahovecit




REGJEP ORUZI *[Signature]* KOMUNAL / AKSIONARË

PERPARIM KRASNIGI - *[Signature]*

HAVALORA HOTI - *[Signature]*

Në bazë të nenit 33 paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nevojës së ushtrimit të Biznesit, themeluesit **Komuna e Rahovecit**, që të dy nga **Rahovec, Rahovec, Xhelal Hajda Toni**, p.n më dt. **11/08/2020** lidhin:

AKTI THEMELIMIT



E SHOQËRISË TREGTARE NDËRMARRJE PUBLIKE LOKALE STACIONI AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A. NË Rahovec, Rahovec, Xhelal Hajda Toni, p.n, Shoqëri aksionare.

Neni 1

Themeluesit pas nënshkrimit të kësaj Marreveshje do të themelojnë Shoqërinë e cila ka statusin juridik të **Shoqëri aksionare** e në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 2

EMËRTIMI I SHOQËRISË

2.1. Biznesi do të afaroj me emërtimin:

SHOQËRIA TREGTARE NDËRMARRJE PUBLIKE LOKALE STACIONI AUTOBUSËVE RAHOVEC Shoqëri aksionare.

2.2. Emërtimi i shkurtuar: **NDËRMARRJE PUBLIKE LOKALE STACIONI AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A..**

Neni 3

LLOJI I SHOQËRISË DHE ADRESA

Shoqeria ka statusin juridik: **Shoqëri aksionare**

Adresa e biznesit është në **Rahovec, Rahovec, Xhelal Hajda Toni, p.n.**

Përfaqësues i/të autorizuar është/janë **Komuna e Rahovecit**, .

Neni 4

PERIUDHA E KOHËZGJATJES

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë si **Shoqëri aksionare** do të jetë në afat të pacaktuar.

Neni 5

QËLLIMI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

Qëllimi i themelimit të Shoqërisë është qëllim i ligjshëm afarist, si dhe përfitimi personal dhe ndihma vendit ku jetojnë me kontribute dhe taksa të ndryshme.

Neni 6

AKSIONARËT E SHOQËRISË

- 6.1. Aksionarët e shoqërisë mund të jenë persona fizik ose juridik, që kanë vënë ose do të kenë në zotërim aksione të shoqërisë, me të gjitha mënyrat e parashikuara me ligj.
- 6.2. Pronësia mbi aksionet e shoqërisë, përmban aderimin me të drejta të plota në statusin e shoqërisë nëpërmes përfaqësimit në Kuvendin e aksionarëve.

Neni 7

TË DREJTAT DHE DETYRAT E AKSIONARËVE

- 7.1. Çdo aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndashme të shoqërisë dhe përfiton proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotëron.
- 7.2. Çdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave, me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që shoqëria mund të ushtroj ndaj aksionarit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 8

DREJTORI

- 8.1. Drejtori i Shoqërisë emrohet: **Behar Gashi nga Rahovec, Zoqishtë, Zoqishtë**, i cili do të ushtroi funksionet e tij nën kontrollin e Kuvendit të aksionarëve.
- 8.2. Drejtori mund të shkarkohet për shkaqe të cenimit të ligjit nga Kuvendi i aksionarëve. Si shkaqe të cenimit të ligjit konsiderohen veqanërisht një faj i rëndë i Drejtorit, pa aftësia e tij në kryerjen korekte të funksioneve ose kur Kuvendi humb besimin tek ai.

Neni 9

KOMPETENCAT

Drejtori ka kompetenca të përcaktuara me Statut për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, kompetenca që i ushtron brenda aktivitetit të shoqërisë.

Neni 10

THEMELUESIT

Themelues të **NDËRMARRJE PUBLIKE LOKALE STACIONI AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A.** në Rahovec, Rahovec, Xhelal Hajda Toni, p.n janë:

Komuna e Rahovecit - Rahovec, Rahovec, Sheh Myhedini p.n.

Neni 11

PROCEDURAT ME TË CILAT NDRYSHOHEN RREGULLORET

Përveç Statutit , shoqëria do të nxjerr edhe akte tjera normative të cilat do të ndihmojnë punën e shoqërisë.

Mënyra e ndryshimit të rregulloreve do të jetë e ngjashme me atë të nxjerrjes së rregulloreve.

Më dt. 11/08/2020

Themeluesit:

1. Komuna e Rahovecit



Pexlepo Omeri Ramo
Përparim Krasniqi - (Përmirësim)
Hamdorg Hata - (Hata)